



Në bazë të nenit 7, alineja 9 e Ligjit për themelimin e Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 72/07 dhe 5/09), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural e shpall këtë

**APEL PUBLIK nr. 02/2010**

**për dërgimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi me masa për përparimin e peshkatarisë dhe të akuakulturës në vitin 2010**

**I. LËNDA E SHPALLJES**

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e mbështetjes financiare për masat në vijim:

<b>Masa 1</b>	<b>Mbështetje financiare për mbrojtjen dhe zhvillimin e florës dhe faunës së ujit</b>	<b>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri)</b>
Nën-masa 1.3	Mbështetje financiare për lëvizjen pa pengesa të peshqve gjatë migrimëve	<ul style="list-style-type: none"><li>- 330.000 denarë</li><li>- Jo më shumë se 3% nga vlera e përgjithshme e pranueshme e projektit për shërbime për përpilimin e projektit ndërtimor</li></ul>
<b>Masa 2</b>	<b>Mbështetje financiare për investime në peshkatori dhe akuakulturë</b>	<b>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme (deri)</b>
Nën – masa 2.1	Mbështetje financiare për zgjerim, përtëritje dhe pajisje në suazat e kapaciteteve për akuakulturë	<ul style="list-style-type: none"><li>- 3.500.000 denarë</li><li>- Jo më shumë se 3% nga vlera e projektit për shërbime për përpilimin e objektit ndërtimor.</li></ul>
Nën – masa 2.2.	Mbështetje financiare për ngritjen (ndërtimin) dhe pajisjen e kapaciteteve të reja	<ul style="list-style-type: none"><li>- 3.500.000 denarë</li><li>- Jo më shumë se 3% nga vlera e përgjithshme e pranueshme e projektit për shërbime për përpilimin e projektit ndërtimor</li></ul>
Nën – masa 2.3	Mbështetje financiare për ripërpunimin, përpunimin, magazinimin, paketimin dhe marketingun e peshqve	<ul style="list-style-type: none"><li>- 3.500.000 denarë</li><li>- Jo më shumë se vlera e përgjithshme e pranueshme e projektit për shërbime për përpilimin e projektit ndërtimor</li></ul>
Nën-Masa 2.4	Mbështetje financiare për kultivimin e peshkoreve me material peshkimi me lloje të peshqve ujëvarës -(ylberi, të Ohrit dhe të troftës së lumenjve) dhe llojeve të peshqve të ujërave të ngrohta (krap, amur, tolstolobik, silur)	<ul style="list-style-type: none"><li>- 40% nga vlera e materialit të peshkimit, përkatësisht nga çmimi mesatar i materialit të peshkimit të cilin e përcakton Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së ujërave edhe atë për periudhën prej vitit 01.01.2010 deri në ditën e dërgimit të Kërkesës për pagesë</li></ul>



## II. E DREJTA PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve e kanë subjektet në vijim, edhe atë për masat:

<b>Subjektet</b>	<b>Nën –Masa</b>
Shfrytëzuesit e kanaleve përçuese, të turbinave dhe kanale të tjera, të cilat e pengojnë lëvizjen normale të peshqve në ujërat e peshkimit dhe koncesionerët e peshqve në ujë peshkimi në të cilat gjenden (janë ndërtuar) pengesat	1.3
Subjektet që kanë leje për akuakulturë të lëshuara nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe janë të regjistruara në regjistrin e kultivuesve të peshqve	2.1
Subjekte që posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të patundshme në të cilën planifikojnë të të ndërtojnë kapacitet për peshq ose kanë siguruar leje përkatëse për shfrytëzimin e ujit nëse është fjala për vendosjen e platformave (kafaz) për kultivimin e peshkut	2.2
Subjektet që kanë leje për akuakulturë të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave dhe janë të regjistruar në regjistrin e kultivuesve të peshqve, organizata të prodhuesve të regjistruar në regjistër i cili mbahet në Ministri në pajtim me Ligjin për peshkari dhe akuakulturë, për me formë juridike të kooperativës dhe koncesionerët e peshqve për peshkim ekonomik.	2.3
Personat fizikë dhe juridikë, dhe kooperativat të cilat kanë leje për akuakulturë dhe të cilët materialin e peshkimit e kanë blerë nga peshkore të cilat kanë leje për prodhimin e materialit të peshkimit	2.4

## III. LARTËSIA E MBËSHTETJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investimi për furnizim me mjete të reja themelore, shpenzime operative të lidhura me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me **Programin me masa për përparimin e peshkatarisë dhe akuakulturës në vitin 2010 (Gazeta zyrtare nr. 07/10, 75/10)**.

Mbështetja financiare paguhet sipas parimit të bashkëfinancimit të investimeve të kryera dhe të paguara nga ana shfrytëzuesit në lartësi prej 50% të vlerës së shpenzimeve të lejuara të pranueshme për investime.

Për Masën 2, përpos për nën-masën 2.4, zëri për bashkëfinancim rritet në raste të caktuara, dhe paraqet:

- 55% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dërguara nga bartësi i ekonomisë bujqësore prej moshës prej 18 deri në 40 vjeç në ditën e dërgimit të investimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore;
- 60% nga vlera e investimit të lejuar, për investime në ekonomi bujqësore e cila gjendet në rajon rural kodrinor-malor;
- 65% nga vlera e investimit të lejuar, për investime të dërguara nga bartësi i ekonomisë bujqësore moshën prej 18 deri në 40 vjeç në ditën e dërgimit ose grua bartëse e ekonomisë bujqësore e cila gjendet në rajon rural kodrinor-malor.

Mbështetja e ndarë financiare është e pakthyeshme.

## IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DËRGOHET

Kërkesat për nën-masë dërgohen në ekzemplar origjinal.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkuarit e mjeteve, janë përcaktuara me **Programin me masa për përparimin e peshkatarisë dhe akuakulturës në vitin 2010 (Gazeta zyrtare nr. 07/10, 75/10)**.

Nëse në Agjenci dërgohen më shumë kërkesa se sa ka mjete në dispozicion në pajtim me **Programin me masa për përparimin e peshkatarisë në vitin 2010**, Agjencia do t'u japë përparësi atyre kërkuarëve të cilët kërkesën e vet e kanë dërguar më herët se të tjerët.

Kërkuarit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimeve para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim përveç në nën-masën 2.4 ku kërkesa për pagesë dërgohet pa Marrëveshje të lidhur paraprakisht me Agjencinë.



## V. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët-Kërkesa ç'r shfrytëzimin e mjeteve dhe kërkesa për pagesën për në-masën 2.4 së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme Udhëzim për shfrytëzuesit mund të merret në ueb faqen e Agjencisë [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk), çdo ditë pune prej 8:30 deri më 16:30.

Formularët e lartpërmendur mund të merren edhe direkt në Agjenci në adresën:

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,  
rr. Skupi nr. 3-a, (ndërtesa FONKO)  
1000 Shkup**

## VI. MËNYRA E DËRGIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzimin e mjeteve nga Programi me masat për përparimin e peshkararisë dhe akuakulturës në vitin 2010 në gjuhën maqedonishte së bashku me dokumentacionin e përgjithshëm, dërgohen në zarf të mbyllur me shenjën në anën e përparme të zarfit në këndin e epërm të majtë "MOS E ÇIL" për Apel publik numër 02/2010 dhe shënjimin e shifrës së masës/nën-masës për të cilën dërgohet kërkesa. Kërkesa mund të dërgohet me postë ose në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për shkapërderdhjen ose hapjen para kohe të kërkesës.

**Afati i fundit për dërgimin e kërkesave është 09.08.2010. Kërkesat e dërguara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen.**

**Kërkesa e plotësuar për pagesë për nën-masën 2.4 së bashku me dokumentacionin përcjellës mund të dërgohet me postë ose personalisht në arkivin e Agjencisë më së voni deri më 26.11.2010, duke filluar nga dita e shpalljes së këtij apeli.**

Informata më të hollësishme në tel. (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresën: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) dhe në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për lejimin e projekteve.

Telefoni **02 3097460**, çdo ditë pune prej orës 10.00 deri në 14.30

E-posta: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk)